



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 22

Prishtinë, më 23 nëntor 2011, në orën 11: 00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Salihe Mustafa, Bahri Thaçi, Sasha Gjokiq, Nazane Breca dhe Liburn Aliu.

Mungoi: Gëzim Kelmendi, Flora Brovina

Të pranishëm: Aurora Bakalli- deputete, Shpresa Haxhijaj, administratore e Komisionit, Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi, Ervin Ibrahim- UNDP.

Mbledhjen e kryesoi: Fikrim Damka, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 16.11.2011
3. Shqyrtimi i Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 02/I-17 për shërbime sociale dhe familjare, para miratimit në parim
4. Shqyrtimi i Projektligjit për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkesve, para miratimit në parim
5. Të ndryshme

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

1.Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të datës 26.10. 2011

Kryesuesi konstatoi se Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale pa vërejtje e miratoi procesverbalin e datës 16 nëntor 2011.

3. Shqyrtimi i Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 02/l-17 për shërbime sociale dhe familjare, para miratimit në parim

Fikrim Damka- Tha se ky projektligj është plotësim-ndryshim i ligjit ekzistues. Ne duhet të diskutojmë dhe mëpastaj ta formojmë një nëngrup për shqyrtimin dhe amendamentimin e këtij projektligji.

Time Kadriaj- U pajtua për miratimin në parim të këtij projektligji dhe tha se vërejtjet eventuale do t'i japim në seancën plenare.

Salihe Mustafa- Deklaroi se është punë e mirë ardhja e këtij projektligji në shqyrtim dhe në parim e përkrah miratimin e tij. Për këtë projektligj konsideroj se ka nevojë të angazhohet një ekspert.

Nazane Breca- Tha se e kemi analizuar projektligjin, por ende duhet ta analizojmë dhe në parim e përkrah miratimin e tij. Duhet të saktësohen mirë kompetencat e nivelit lokal dhe atij qendror në lidhje çështjet që trajton ky projektligj.

Liburn Aliu- Duke diskutuar për projektligjin, tha se për arsye se plotësim-ndryshimi ka të bëjë me dhënien e kompetencave pushtetit lokal, këtu kemi ndërhyrje politike të çështjet sociale. Prandaj, është i nevojshëm angazhimi i një eksperti, në mënyrë që të harmonizohen këto ndryshime në përputhje me ligjin.

Pas diskutimeve, Komisioni vendosi që të miratojë Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 02/l-17 për shërbime sociale dhe familjare, para miratimit në parim dhe mori vendim për formimin e grupit punues për shqyrtimin e këtij projektligji, në këtë përbërje: Bahri Thaqi- kryesues, Nazane Breca, anëtare dhe Time Kadriaj, anëtare.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkuesve, para miratimit në parim

Komisioni njëzëri miratoi Projektligjin për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkuesve, para miratimit në parim dhe mori vendim për formimin e grupit punues për shqyrtimin e këtij projektligji, në këtë përbërje: Gëzim Kelmendi- kryesues, Liburn Aliu, anëtar dhe Sasha Gjokiq, anëtar.

5. Të ndryshme

Fikrim Damka- Tha se nëngrupi i ka shqyrtuar amendamentet e dërguara nga Komisioni i buxhetit. Tash ne duhet të mblidhemi dhe të diskutojmë për këtë projektligj, në mënyrë që ta miratojmë sa më shpejt. Mendoj së javën tjetër, të martën, ta kemi mbledhjen e Komisionit dhe ta shqyrtojmë këtë projektligj. Duhet të kemi një qëndrim të qartë nga të gjitha grupet parlamentare lidhur me datën e luftës. Po ashtu, duhet të diskutojmë edhe për buxhetin, që lidhet me të dy ministrinë.

Çështje problematike është ajo e punëtorëve të Institutit special të Shtimes, të cilët kanë paralajmëruar protesta, nëse nuk përfshihen për t'u paguar si punëtorë shëndetësorë.

Salihe Mustafa- Deklaroi se Ministria e Administratës ka vullnet për ta pranuar kërkesën e tyre për t'i paguar ata si punëtorë shëndetësorë. Ne, si Komision, do ta bëjmë punën tonë dhe atyre do t'u zgjidhet problemi.

Liburn Aliu- Propozoi që sa më shpejt të ftohen në Komision të dy ministrat dhe të diskutohet për buxhetin që u takon këtyre dy ministrive. Vërejtjet tona duhet t'i harmonizojmë me kërkesat e tyre, në mënyrë që të shohim mundësitë që të ndryshojmë diçka në linjat buxhetore të parapara. Buxheti është ndër çështjet më urgjente.

Salihe Mustafa- Nuk u pajtua që të ftohen ministrat në Komision për të diskutuar lidhur me projektbuxhetin.

Komisioni vendosi që javën e ardhshme, të mërkurën, më 30 nëntor, t'i ftojë ministrin e shëndetësisë dhe ministrin e punës dhe mirëqenies sociale, për të diskutuar lidhur me projektbuxhetin për këto dy ministri.

Komisioni gjithashtu vendosi që pas leximit të parë të Projektligjeve, të mbahet një punëtori dyditore në të cilën punëtori do të bëhej amendamenti i dy Projektligjeve, në mënyrë që brenda këtij viti, amendamentet të procedohen në Kuvend.

Aurora Bakalli- Deklaroi se kam qenë aktive si anëtare e grupit punues dhe do të ishte e arsyeshme të isha e informuar për mbledhjet e mëtejshme të këtij grupi dhe, po ashtu, dëshiroj t'i kam amendamentet e propozuara.

Liburn Aliu- Shprehu interesimin për të qenë pjesë e grupit punues për monitorimin e Ligjit për Inspektoratin e punës.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka

